




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-4200/13
 Dep. 02 Br. Prot. 06.12.2013
 Nr. ffaq. 02 Prot. No. 06.12.2013
 Broj stranica 02 Datum 06.12.2013
 Nr. pages 02 Date 06.12.2013

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-2512\13, për zyrtarin e lartë z. Adem Kadolli, Shef i Inspeksionit, në Komunën e Suharekës (Therandes), për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-2512/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, z. Adem Kadolli, Shef i Inspeksionit, në Komunën e Suharekës (Therandes).

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Shef i Inspeksionit, është duke ushtruar edhe një funksion në biznesin e tij private "N.T.SH Agro -Theranda", e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 08.11.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Adem Kadolli, Shef i Inspeksionit, në Komunën e Suharekës (Therandes), pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë, ka kërkuar që ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, në ushtrim të funksionit publik, z. Kadolli, është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet, mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar askush që nga momenti i zgjedhjes në funksion publik, dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mund të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, dhe është zotuar se do të filloj menjëherë procedurat për autorizimin e një personi që ta administroi biznesin e tij gjatë kohës sa ushtron funksion publik.

Zyrtari i lartë, z. Adem Kadolli, Shef i Inspeksionit, në Komunën e Suharekës (Therandës), pas kesaj ka sjellë dëshmitë nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka autorizuar një person për ta udhëhequr biznesin "N.T.SH Agro – Theranda".

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë z. Adem Kadolli, Shef i Inspeksionit, në Komunën e Suharekës (Therandes), pasi ka bërë ndryshimet në biznesin e tij privat "N.T.SH Agro – Theranda" dhe nuk ushtron me pozitë menaxhariale në këtë biznes, deshmohet se ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

